



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 137, Datë 12.06.2020.

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT

Në mbështetje të nenit 143, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 189/1/c, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 34, dt. 10.04.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe në nenin 8, të Vendimit nr. 26, dt. 22.02.2019, “Rregullore për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren **Manjola Kajana**, si eksperte pranë UNODOC (*United Nations Office on Drugs and Organized Crime*), zyra në Vjenë, Austri, në kuadër të projektit Global Firearms Programe, për të përgatitur një përmbledhje me raste praktike gjyqësore për veprën penale “*Prodhim dhe mbajtje e armëve dhe municioneve*”, të parashikuar nga nenet 278 dhe 278/a, të Kodit Penal, si dhe për të rishikuar, në gjuhën Shqipe, dokumentin “*Udhëzues mbi provat elektronike*”, të përgatitur nga UNODOC. Veprimtaria do të ushtrohet jashtë orarit të punës për periudhën 01.07.2020-30.10.2020.
2. Të njoftohen për këtë vendim prokurorja Manjola Kajana dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GËNT IBRAHIMI

ANËTAR
BUJAR SHLISHI

ANËTARE
ESMERALDA CAMI KESHI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTARE
NURIHAN SEITAJ

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

